

Në të njëjtën varkë, në stuhi

*Nga Marek Belka dhe Srobona Mitra
Gazeta Shqiptare, 13 Maj 2009*

Të goditur nga një stuhi e dyfishtë e pakësimit të flukseve hyrëse të kapitaleve si dhe tkurrjes së eksporteve, vendet në zhvillim të Europës janë në një krizë të thellë. Iluzioni i mospërfshirjes në krizë është zhdukur dhe është e qartë tani se rimëkëmbja nuk do të varet vetëm nga bërja e zgjedhjeve politike të duhura brenda vendit, por gjithashtu nga zhvillimet dhe vendimet në pjesën tjetër të Europës. Kontinenti është zhvilluar shpejt gjatë dekadës së fundit nëpërmjet lidhjeve tregtare dhe financiare gjithnjë e më të ngushta që kanë sjellë rritjen ekonomike dhe konvergjencën në të ardhura. Si rezultat, gjithë Europa sot është në të njëjtën varkë, duke u përballur me të njëjtën kohë të keqe—dhe vendet e zhvilluara e ato në zhvillim duhet të kordinojnë së bashku rrugëdaljen Qeveritë dhe bankat qendrore kanë ndërmarrë veprime të paprecedenta për të adresuar krizën dhe po bëhen përpjekje për të koordinuar politikën. Por shumë më tepër duhet bërë në të dyja aspektet.

Kriza ka dëmtuar disa më shumë se të tjerët, duke vënë në fokus diferenca të dukshme në politika. Ashtu sikurse dhe thuhet në botimin e ri *Parashikimi Ekonomik Rajonal*, efekti pozitiv i anëtarësimit në BE u zhdruk pothuajse brenda ditës dhe tregjet financiare filluan t'i shihnin vendet me imtësi për politikën e tyre bazë. Vendet me inflacion të lartë dhe me defiçite në llogarinë korente, apo ato që e kanë financuar bumën e kredive duke marrë hua nga jashtë, janë dëmtuar më shumë. Kjo sygjeron fort se politikën e shëndosha makroekonomike dhe financiare janë me përfitim. Qeveritë do të ecin me kujdes kur vjen puna për stimuj fiskalë dhe shumë të tjerëve do t'u kërkohet të kontrollojnë defiçitet për të rifituar besimin në qëndrueshmërinë e politikave të tyre. Kjo do të ndihmojë gjithashtu në parandalimin e lëvizjeve të mëdha në kurset e këmbimit, çka është veçanërisht e rëndësishme në një rajon ku shumë kanë marrë hua në euro, franga zvicerane dhe të tjera monedha të huaja. Përmirësimi i besueshmërisë së politikave, për shembull duke forcuar institucionet politikë-bërëse që mbështesin qëndrueshmërinë fiskale është shumë e rëndësishme në këtë aspekt. Një tjetër çështje e rëndësishme ndër ato që duhen bërë mbeten reformat strukturore. Për shembull, tregjet fleksibël të punës dhe mjedisi pozitiv i biznesit do të ndihmojnë në lehtësimin e zhvendosjes së nevojshme të burimeve drejt sektorëve të tregtueshëm dhe do të rrisin produktivitetin gjatë periudhës së axhustimit me flukse të zvogëluara kapitalesh. Këto politika janë akoma më të rëndësishme për ato vende që kanë norma të fiksuara të kursit të këmbimit, të cilat duke mos pasur rrugëdalje eksplicite për momentin, kanë pak zgjedhje përveç se shtrëngimit të politikave fiskale dhe përshtetimit të ndryshimeve strukturore.

Por kriza e bëri të qartë se integrimi ekonomik ia ka kaluar koordinimit makroekonomik dhe të politikave të sektorit financiar në Europë. Një fushë me një nevojë urgjente për koordinim është rregullimi i bankar. Është e qartë se bankat në Europën në zhvillim kishin ndërmarrë risqe të konsiderueshme kur ato nxitën një rritje të jashtëzakonshme të kredisë dhe një bum të kërkesës pa krijuar mbrojtësit e përshtatshëm në rast të një rënie. Por shumë nga këto banka i kanë bankat mëmë në vendet e zhvilluara të Europës dhe shpesh mbikqyrësit e bankave mëmë vetë nuk i kishin mjetet për të garantuar një sjellje më të matur. Tani, kur këto banka

kanë nevojë për rikapitalizim, koordinimi më i mirë midis mbikqyrësve të bankave mëmë dhe atyre në vend është kyç. Bilancet e shëndosha të bankave janë parakusht për të ruajtur flukset e shëndetshme të kredisë drejt firmave dhe konsumatorëve, e cila nga ana tjetër është e nevojshme për të forcuar kërkesën dhe rritjen në shumicën e vendeve në zhvillim.

Kjo është një nga arsytet pse përpjekjet për të zgjidhur këto çështje janë të mbështetura nga Fondi Monetar Ndërkombëtar që po punon së bashku me Komisionin Europian. Një tjetër fushë bashkëpunimi janë çështjet monetare dhe të kursit të këmbimit. Për shembull Banka Qendrore Europiane ka qenë mjaft selektive në mbështetjen e monedhave të vendeve që nuk janë në eurozonë dhe diskutimet për të përcaktuar rrugën për adoptimin e euros për ato vende që kanë politika të besueshme dhe baza të shëndosha ekonomike, sapo kanë nisur. Duke parë boshllëqet në informacion midis vendeve në zhvillim të Europës dhe vendeve të eurozonës, mbushja e boshllëkut të koordinimit në të gjitha këto fusha do të ndihmojë në shmangien e luhatjeve të padëshëruara në kurset e këmbimit dhe në tregjet financiare.

Konvergjencia e Europës ka qenë një nga historitë më të suksesshme që nga rënia e perdes së hekurt—por me këtë sukses vjen gjithashtu dhe dhimbja e një recesioni të përbashkët. Ja pse kjo krizë nuk është vetëm një kujtesë e fuqishme për një rikthim në politika ekonomike të shëndetshme. Është gjithashtu një thirrje urgjente për të ndërmarrë një qasje të koordinuar për politikat kyçe në të gjithë Europën, përfshirë këtu edhe ndërtimin e një kuadri aq të nevojshëm të stabilitetit financiar që përfshin vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, si dhe një përpjekje të përbashkët për të parandaluar luhatje të befta në kursin e këmbimit.

Nëse ka ndonjë mësim që do të zgjasë nga kjo krizë për Europën është se një rajon shumë i integruar kërkon prespektiva rajonale prej politikbërësve. Me fjalë të tjera, për të hartuar rrugën jashtë stuhisë së tanishme do të duhet më shumë dhe jo më pak Europë.

**Marek Belka është Drejtor i Departamentit Europian, Srobona Mitra është ekonomiste në këtë departament.*